




Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse / Privremena Institucija Samouprave / Provisional Institutions of Self Government
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Shërbimeve Publike / Ministarstvo javnih službi / Ministry of Public Services

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Llogarit Qeveritare të Kosovës

2003



Enti i Statistikës së Kosovës
Zavod za Statistiku Kosova
Statistical Office of Kosovo

Parathënie

Publikimi “Llogaritë Qeveritare të Kosovës për vitin 2003” është publikimi i dytë me radhë i publikuar nga Enti Statistikor i Kosovës (ESK). Botimi i tillë paraqet pasqyrën reale të të hyrave dhe shpenzimeve qeveritare brenda kësaj periudhe.

E gjithë kjo është punë e mbështetur edhe në ndihmën e ekspertit ndërkombëtar Geert Langenous nga Instituti ICON. Këtë raport e ka përgatitur Shkelzen Ademi dhe Emine Bajrami, në bashkëpunim me Xhevrie Fetahu dhe Bujar Uka , si dhe drejtorin e statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare Z. Ilir T. Berisha.

ESK-ja i është mirënjohës Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave (MEF), Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK) si dhe Bankës së Pagesave të Kosovës (BPK-së) në ofrimin e të dhënave në lidhje me këtë publikim .

Komentet, propozimet dhe sugjerimet e juaja janë të mirëseardhura dhe ato mund të drejtohen në këtë e-mail: economic@ks-gov.net me qëllim të përmirësimit të kualitetit të këtij publikimi.

Shef Ekzekutiv i ESK,
Hysni Thaçi

Prishtinë, Nëntor 2005

Lista e referencave

FMN (2003)

Ministria e Ekonomisë dhe e Financave (2003) Thesari

Administrata Tatimore e Kosovës (2003)

Ministria e Ekonomisë dhe e Financave (2003) Monitori Makroekonomik Mujor

Enti i Statistikës së Kosovës (2003) Statistikat e tregtisë së jashtme

Shkurtesat

FMN	Fondi Monetar Nderkombetar
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
ESA	European Statistical Accounts (Llogaritë Statistikore Evropiane)
TKPK	Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës
ATM	Administrata Tatimore e Kosovës
ESH	Ekonomitë shtëpiake
:	Shifrat nuk janë disponibël
—	Nuk aplikohet

Përmbajtja

1	H y r j e	5
2	T ë a r d h u r a t, s h p e n z i m e t d h e n e t o a f t ë s i a f i n a n c i a r e p ë r Q e v e r i n ë e P ë r g j i t h s h m e.....	6
3	S i s t e m i i f o n d i t p e n s i o n a l.....	8
4	V ë r e j t j e p ë r m b y l l ë s e	11
	Table 1: Grantet e donatorëve.....	6
	Table 2: Pjesmarrja e tatimeve te brendshme dhe kufitare ne te hyrat buxhetore	6
	Table 3: T ë a r d h u r a t, s h p e n z i m e t d h e n e t o a f t ë s i a f i n a n c i a r e e Q e v e r i s s ë p ë r g j i t h s h m e t ë K o s o v e s.....	7
	Table 4: Treguesit kryesor për shtyllen II-të pensionale të Kosovës	8
	Table 5: T ë a r d h u r a t, s h p e n z i m e t d h e n e t o a f t ë s i a f i n a n c u e s e e Q e v e r i s ë q ë n d r o r e	9
	Table 6: T ë a r d h u r a t, s h p e n z i m e t d h e n e t o a f t ë s i a f i n a n c u e s e e Q e v e r i s l o k a l e	10

1 Hyrje

Publikimi i llogarive qeveritare të vitit 2003 është publikimi i dytë i këtij lloji, i cili paraqet një pasqyrë të të ardhurave dhe shpenzimeve brenda këtij viti, kjo mbështetet në të dhënat e grumbulluara dhe monitoruara nga zyrtarët e ESK-së. Si rregull e përgjithshme është pajtueshmëria maksimale e shifrave të publikuara me standardet e ESA 95 (Eurostat, 1996).

Në Kosovë dominon një qeverisje e dyfishtë: njëra nga Qeveria e Kosovës, kurse tjetra nga UNMIK-u , gjë e cila ka krijuar paqartësi dhe nuk dihet me saktësi se si të regjistrohen aktivitetet e organizatave ndërkombëtare (UNMIK, KFOR), të cilat ofrojnë shërbime të tipit qeveritar në fushat të cilat nuk janë të mbuluara nga Qeveria e vendit, kontributi i të cilave është mjaft i rëndësishëm. Tani për tani ESK-ja do t'i konsiderojë si agjentë jo rezident dhe do të mbajë aktivitetet e tyre jashtë llogarisë së Qeverisë së Kosovës. Kjo nuk do të thotë se do të mbetet kështu, sepse në të ardhmen trajtimi statistikor i UNMIK-ut dhe KFOR-it nga ana e ESK-se mund të ndryshojë.

Në Seksionin 1 janë paraqitur të ardhurat dhe shpenzimet e Qeverisë së përgjithshme, Seksioni 2 shtjellon neto aftësinë financiare, Seksioni 3 përqëndrohet në sistemin pensional të Kosovës (e cila nuk është pjesë e Qeverisë së përgjithshme në kuptimin e llogarive të ESA '95) dhe Seksioni 5 paraqet një pjesë të vërejtjeve.

2 Të ardhurat, shpenzimet dhe neto aftësia financiare për Qeverinë e Përgjithshme

Totali i të ardhurave të Qeverisë së përgjithshme është rreth 850 milion euro në vitin 2003, që do të thotë se kemi një zvogëlim të të hyrave në krahasim me vitin e kaluar prej rreth 40 milion. Prej tyre rreth 250 milion ose rreth 30% të hyrave të përgjithshme përbëhen nga ndihma e donatorëve. Kjo përqindje e pjesëmarrjes së donacioneve në vitin 2002 ka qenë rreth 40 %, duke përfshirë edhe mbështetjen e buxhetit nga ndihmat që kapë shumën rreth 18,1 milion.

Është me rëndësi të përmendet se buxheti i vitit 2003 është financuar plotësisht nga burimet e gjeneruara në vend, çka do të thotë se nuk është marrë asnjë grant për mbështetje të buxhetit. Pra, kemi pasur një rënie të mbështetjes së buxhetit nga donacionet e jashtme që nga viti 2000, kurse në vitin 2003 nuk kemi pasur fare mbështetje. Po ashtu këtu na paraqiten edhe zotimet e bartura prej vitit 2002, të cilat kapin shumën prej rreth 157 milion eurove.

Table 1: Grantet e donatorëve

Vitet	në million euro	
	Mbështetjet buxhetore	Përcaktimet e granteve
2000	120.8	40.1
2001	41.1	42.3
2002	18.1	20.8
2003	:	29.1

Burimi : Monitori makroekonomik mujor – MEF (2003)

Rreth 70 % e të hyrave përbëhet nga të ardhurat vetjake. Pjesa më e madhe vjen nga tatimi i mallrave dhe shërbimeve, ndërsa pjesa tjetër e tatimeve mbetet paksa më e vogël që prej vitit në vit, mirëpo edhe kjo pjesë po aktivizohet. Sa i përket tatimit, pjesa më e madhe e të hyrave sigurohet në tatimet kufitare, e kjo shihet në tabelën e mëposhtme.

Table 2: Pjesmarrja e tatimeve të brendshme dhe kufitare në të hyrat buxhetore

të shprehura në përqindje 2003		
Taksat kufitare	Taksat e brendshme	Totali
80	20	100

Burimi : Administrata tatimore e Kosovës – MEF (2003)

Totali i shpenzimeve të Qeverisë së përgjithshme është llogaritur të jetë rreth 791 milion euro. Rreth 79 % i përkasin shpenzimeve rrjedhëse. Edhe në këtë vit konsumi i ndërmjetëm p.sh blerja e mallrave dhe shërbimeve paraqet kategorinë më të rëndësishme të shpenzimeve rrjedhëse,(vlerësohet rreth 43 %) të shpenzimeve rrjedhëse). Te transferet rrjedhëse kemi një rritje të shpenzimeve në krahasim me vitin e kaluar prej rreth 20 milion.

Edhe këtu shpenzimet kapitale kanë një rëndësi të madhe, edhe pse këtë vit kemi një rënie të shpenzimeve kapitale.

Table 3: Të ardhurat, shpenzimet dhe neto aftësia financiare e Qeveris së përgjithshme të Kosoves

	në milion euro, viti 2002/2003	
Te ardhurat	899.2	835.3
Te ardhurat rrjedhese	702.3	780.9
Tatimet rrjedhëse në të hyra dhe pasuri	56.0	68.1
Paguat nga ekonomit shtëpiake	19.2	30.9
Paguat nga ndërmarrjet	36.8	37.2
Tatime në prodhime dhe importe	401.5	472.9
Tatimet në produkte	396.6	466.2
Tatimet tjera të prodhimit	4.9	6.7
Kontributet sociale	:	:
Transferet rrjedhëse	218.0	194.6
Dhuruesit e ndihmave nga bota e jashtme	205.6	184.6
Tjerat	12.4	10.0
Të hyrat nga interesi	3.7	3.1
Shitjet	23.2	42.2
Të ardhurat kapitale	196.8	54.4
Tatimet kapitale	:	:
Investimet e granteve	137.4	40.5
Transferet tjera kapitale	59.4	13.9
Shpenzimet	792.2	791.6
Shpenzimet rrjedhëse	557.5	624.3
Kompensimi i punëtorëve	131.3	150.9
Konsumi i ndërmjem	315.1	353.0
Transferet rrjedhëse të ekonomis shtëpiake	59.0	59.9
Subvencionet	52.1	60.5
Shpenzimet kapitale	234.7	167.3
Bruto akumulimi fiks i kapitalit	153.3	133.0
Investime e granteve	81.4	34.3
Fuqia financiare neto	106.9	43.7

Në përgjithësi në vitin 2003 sikurse edhe në vitin 2002 të ardhurat i tejkalojnë shpenzimet me një diferencë të madhe, ku llogaria e Qeverisë së përgjithshme në vitin 2003 tregon një suficit prej 44 milion euro. Në krahasim me vitin 2002 neto kapaciteti financiar është më i vogël për 62 milion, që tregon se kemi rritje të konsiderueshme të shpenzimeve rrjedhëse në Qeverinë lokale.

3 Sistemi i fondit pensional

Sistemi i sigurimit social është disi më i komplikuar dhe po thuajse është jashtë suazave të Qeverisë, por që menaxhohet nga shtylla e III e UNMIK-ut (këtu përfshihen kontributet pensionale).

Sistemi pensional i Kosovës përbëhet prej dy shtyllave:

E para është skema e asistencës themelore sociale në bazë të kontrollit të nevojave, e cila është e zbatueshme për të moshuarit dhe është e integruar në Qeverinë qendrore, që do të thotë se është pjesë përbërëse e Qeverisë dhe pagesat pensionale nën këtë konsiderohen si dobi sociale të përfshira në shpenzimet të Transferet rrjedhëse të ESH. Kjo është e financuar nga Qeveria e përgjithshme

E dyta është skema e financimit detyrues, e cila për herë të parë është zbatuar më 1 gusht 2002, ndërsa më 1 gusht 2003 është zëvendësuar me skemë gjithëpërfshirëse që aplikohet nga punëdhënësit dhe të punësuarit.

Kjo pjesë nuk menaxhohet nga Qeveria, por nga një institucion i veçantë, Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK). TKPK pranon kontribute pensionale aktualisht 10% prej bruto pagave në mes të punëdhënësve dhe punëtorëve, ndërsa për vetë të punësuarit 10 % të të ardhurave të fituara. TKPK i mbikëqyrë investimet e këtyre fondeve, të cilat janë të menaxhuara nga dy kompani. Sistemi i tillë nuk është edhe aq i komplikuar, të gjithë ata që dëshirojnë të dinë mbi fondin e vet, këtë mund ta bëjnë. Po ashtu ata kanë të drejtë edhe në pensione vjetore.

Edhe pse kjo pjesë është regjistruar jashtë Qeverisë, në të ardhmen do të jetë gjithnjë e më i rëndësishme. Kontributet e pagesave të pensioneve janë rrjedha në mes të ESH dhe sektorit të korporatave financiare.

Nga këndvështrimi ekonomik nuk duket të jetë plotësisht e kënaqshme që sistemi kryesor pensional i detyrueshëm nuk është reflektuar në llogarinë e Qeverisë. Kështu që publikimet e ESK-së për Llogaritë Qeveritare, në parim përmbajnë një vështrim, pro memorie, të situatës së shtyllës së financuar .

Table 4: Treguesit kryesor për shtyllen II-të pensionale të Kosovës

në milion euro, viti 2003

Kontributet	Të ardhurat e mjeteve	Pagesat e pensioneve	Mjetet (fondi i vitit)
53.4	0.81	–	54.29

Burimi: trusti pensional i Kosovës

Në vitin 2002 kontributet e përgjithshme pensionale kanë qenë rreth 8 milion, në vitin 2003 kemi një rritje të kontributeve prej më se 40 milion, ndërsa pagesat edhe në vitin 2003 kanë qenë zero.

Shtojca: Llogaritë e hollësishme për nën-sektoret e Qeverisë së Përgjithshme

Table 5: Të ardhurat, shpenzimet dhe neto aftësia financuese e Qeverisë qendrore
në milion euro, viti 2002/2003

Te ardhurat	882,1	810,3
Te ardhurat rrjedhese	685,3	755,9
Tatimet rrjedhese ne te hyra dhe pasuri	55,8	64,5
Pague nga ekonomit shtëpiake	19,0	27,3
Pague nga ndërmarrjet	36,8	37,2
Tatimet në prodhime dhe importe	399,9	470,1
Tatimet në produkte	396,6	466,2
Tatimet tjera në prodhim	3,3	3,9
Kontributet sociale	:	:
Transferet tjera rrjedhese	212,8	192,0
Dhuresit e ndihmave nga bota e jashtme	205,6	184,6
Tjera	7,2	7,3
Të hyrat nga interesi	3,7	3,1
Shitjet	13,2	26,3
Të ardhurat kapitale	196,8	54,4
Tatimet në kapital	:	:
Investimet e granteve	137,4	40,5
Transferet tjera kapitale	59,4	13,9
Shpenzimet	787,8	772,7
Shpenzimet rrjedhëse	468,5	491,4
Kompensimi i punëtorve	77,9	67,9
Konsumi i ndërmjetëm	279,5	303,1
Transferet rrjedhëse te ekonomis shtëpiake	59,0	59,9
Subvencionet	52,1	60,5
Shpenzimet kapitale	234,7	167,3
Gros fix capital formation	153,3	133,0
Investimet në grante	81,4	34,3
Transferet rrjedhese te qeveris lokale	84,6	114
Fuqia neto financiare	94,3	37,5

Table 6: Të ardhurat, shpenzimet dhe neto aftësia financuese e Qeveris lokale

në milion euro, viti 2002/2003		
Te ardhurat	101,6	139,0
Te ardhurat rrjedhese	101,6	139,0
Tatimet rrjedhëse në të hyra dhe pasuri	0,2	3,6
Paguar nga ekonomit shtëpiake	0,2	3,6
Paguar nga ndërmarrjet	:	:
Tatimet në prodhime dhe importe	1,6	2,8
Tatimet në produkte	:	:
Tatimet tjera në prodhime	1,6	2,8
Kontributet sociale	:	:
Transferet rrjedhëse	5,2	2,7
Dhuruesit e ndihmave nga bota e jashtme	:	:
Tjerat	5,2	2,7
Të hyrat nga interesi	:	:
Shitjet	10,0	15,9
Transferet rrjedhëse prej qeveris qendrore	84,6	114,0
Të ardhurat kapitale	:	:
Tatimet kapitale	:	:
Investimet e granteve	:	:
Transferet tjera kapitale	:	:
Shpenzimet	89,0	132,9
Shpenzimet rrjedhëse	89,0	132,9
Kompenzimi i punëtorve	53,4	83,0
Konsumi i ndërmjem	35,6	49,9
Transferet rrjedhëse te ekonomis shtëpiake	:	:
Subvencionet	:	:
Shpenzimet kapitale	:	:
Bruto akumulimi fiks i kapitalit	:	:
Investime e granteve	:	:
Transferet rrjedhëse të qeveris lokale	:	:
Fuqia financiare neto	12,6	6,1 _s

4 Vërejtje përmbyllëse

ESK-ja në vitin 2002 ka nxjerr një publikim, duke u mbështetur në ndihmën e ekspertëve të jashtëm dhe ishte publikimi i parë sa i përket financave qeveritare. Sa i përket grumbullimit dhe monitorimit të të dhënave jemi në fazën fillestare, që do të thotë se kualiteti dhe shtrirja e këtyre të dhënave do të përmirësohet në publikimet e ardhshme (metodologjia e përdorur është e përafërt me ESA'95).

Edhe në vitin 2003 ekzistojnë dy mangësitë që ishin në vitin 2002. Së pari, që të ardhurat e Qeverisë ende regjistrohen në dy pjesë: një pjesë në baza kesh, ndërsa tjetra në baza akruale. Po ashtu edhe të shpenzimet ekziston një ndarje, ndërsa të donacionet kjo do të tejkalohet.

Meqenëse jemi në fillim të grumbullimit dhe monitorimit të të dhënave, çdo koment dhe vërejtje e juaja do të jetë e mirëseardhur, në mënyrë që puna jonë në të ardhmen të jetë më e efektshme dhe të dhënat tona për nevojat e tjerëve të jenë më të arsyeshme.

Enti Statistikës së Kosovës (ESK) – përshkrim i shkurtër

Enti i Statistikës si Ent profesional vepron që nga viti 1948, dhe ka kaluar nëpër të gjitha fazat historike të Kosovës. Me 2 Gusht të vitit 1999 Enti ka rifilluar punën e tij si i pavarur dhe si Institut profesional i administratës publike profesionale. Buxheti i konsoliduar i Kosovës dhe donatorët e ndryshëm për projekte të veçanta e financojnë Entin.

Rregullorja për Statistika (Rregullorja 2001/14) ka hyrë në fuqi me 2 Korrik 2001. ESK është një agjencion ekzekutiv i cili vepron në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike (MSHP). Një Master Plan (plan zhvillimor afatmesëm) për sistemin statistikor është në zhvillim e sipër.

Struktura organizative: Shtatë Zyra Rajonale (Prishtinë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj, Gjilan dhe Mitrovicë, dhe Qendra Kryesore në Prishtinë) për momentin kanë gjithsej 137 të punësuar, 90 të punësuar në QK dhe 47 të punësuar në Zyrat Rajonale. Është 1 ekspertë internacional prezent në përkrahje Entit si dhe 1 asistent gjuhësor. Enti i Statistikës së Kosovës ka një teren krejtësisht të mbuluar për organizimin e anketave me regjistruar me përvojë dhe mundësi të mjaftueshme të transportit. Një organizim i ri i Entit është implementuar kohëve të fundit. Grupi punues mbi Statistikat përfshirë këtu shumicën e Ministrive, është në krijim.

Misioni i Entit është që t'i përmbushë nevojat e përdoruesve për të dhëna statistikore objektive dhe analiza të rregullta në mënyrë që të përkrah departamentet qeveritare dhe t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit dhe përdoruesit tjerë në Kosovë..

- **Adresa:** Enti i Statistikës së Kosovës, Rr."Zenel Salihu" Nr.4, Prishtinë
- **Telefonat:**
Qendra kryesore: +381 (0) 38 235 111
Drejtori: +381 (0) 38 235 545 ose +381 (0) 38 504 604 lok. 6572
- **Fax:** +381 (0) 38 235 033
- **E-mail:** economic@ks-gov.net
- **Web-faqe:** www.ks-gov.net/esk